



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 30/11/2023

PROCES VERBAL

Konsultimi për Planin Social 2024-2027

Vendi : Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Përmet

Ora : 11:00

Tema e konsultimit :Plani Social 2024-2027.

I mbajtur sot më datë 30 Nëntor me pjesëmarrjen e Drejtoreshsës së Shërbimeve Sociale,znj Arjana Papapano, Drejtorisë së Zyrës së Punësimit, punonjës të ndryshëm të Bashkisë Përmet si dhe punonjës nga Policia, Gjykata .Në këtë takim pjesëmarrëse është edhe ekspertja e UNDP, znj.Marsela Dauti.Takimin e hapi znj.Arjana Papapano, e cila fillimisht falenderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe më pas filloi të shpjegojë më në detaje Planin Social për 3 vitet e ardhshme.

Ajo u tregoi të pranishmëve metodologjinë e përdorur për hartimin e këtij plani; fushat, qëllimet, objektivat dhe aktivitetet që do ndodhin në vijim; padyshim u tregoi edhe për buxhetin e parashikuar.Më pas znj.Arjana u shpjegoi të pranishmëve më hollësisht hapat e punës që janë ndjekur për të hartuar këtë plan si dhe metodologjinë e përdorur.

Në vijim ajo tha se Plani Social bazohet në 4 elementë kryesorë që janë :

1. SISTEM I QËNDRUESHËM INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI
2. QASJA NË SHËRBIME SOCIALE
3. STRUKTURAT DHE BURIMET NJERËZORE
4. PROGRAME PARANDALUESE

Në përfundim të fjalës së saj, znj.Arjana Papapano foli mbi buxhetin e nevojshëm për të bërë të mundur realizimin e këtij plani, kostot e parashikuara, burimet e financimit, si dhe mënyrën e financimit sipas burimeve.

Pasi përfundoi së prezantuari të gjithë Planin Social, ajo i falenderoi edhe një herë pjesëmarrësit dhe i ftoi ata të jepnin ide dhe sugjerime mbi këtë plan.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Më pas fjalën e mori znj. Marsela Dauti, eksperte e UNDP, e cila u shpreh se mes tyre dhe institucionit të Bashkisë Përmet ekziston një bashkëpunim mjaft korekt dhe frytdhënës. Gjithashtu ajo foli për disa minuta mbi këtë plan i cili është realizuar në bashkëpunim me Bashkinë Përmet.

Takimi zgjati rreth 1 orë dhe u mbyll në mënyrën më të mirë të mundshme, me të pranishmit të cilët u qartësuan akoma dhe më shumë mbi mënyrën se si do të funksionojë ky plan si dhe veshtirësit dhe sfidat që priten në të ardhmen.

Konceptoi:


Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËR GJITHSHËM

Denisa DURO

Foto nga takimi:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

